



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 946/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Burim Ademi kryesues, Zyhdi Haziri dhe Kymete Kicaj anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit, Valon Kurtaj nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Komunën e Prizrenit, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 të datës 03.11.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**REFUZOHET** i pabazuar apeli Anr.946/2021 i datës 04.11.2021, i paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit, Valon Kurtaj, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Prizren, kundër vendimit Nr.2948/2021 të datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për Kuvendin Komunal, për shpalljen e rezultatit përfundimtar, me të cilën ka kërkuar që të rinumërohen votat në vendvotimit 2033A-02R, 2033A-7R, 2033-01R, 2033A-3R, 2033A-04R, 2033A-05R, 2032A-02D, 2032A-02D, 2049A-02D, 2049A-01R, 2070A-01D.

### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin me datën 04.11.2021 nga anëtari për Kuvend Komunal në Komunën e Prizrenit, Valon Kurtaj nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Komunën e Prizrenit me nr. të listës , me të cilën pretendon se në vendvotimet 2033A-02R, 2033A-7R, 2033A-01R, 2033A-3R, 2033A-04R, 2033A-05R, 2032A-02D, 2032A-02D, 2049A-02D, 2049A-01R, 2070A-01D ka mungesë të votave sipas deklaratave të familjarëve dhe miqve të tij me të cilën thekson se e kanë votuar. Më tutje në apel thekson se ka dyshime tek komisionerët dhe vëzhguesit gjatë numrimit ë votave.

Andaj përmes apelit ka kërkuar që të bëhet rinumërimi në Vendvotimet 2033A-3R, 2033A-04R, 2033A-05R, 2032A-02D, 2032A-02D, 2049A-02D, 2049A-01R, 2070A-01D.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi apelin, vlerësoi se:

### **Apeli është i pabazuar**

Nga shkresat e lëndës rezulton se kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit, Valon Kurtaj, brenda afatit ligjor ka parashtruar apelin ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në vendvotimet 2033A-02R, 2033A-7R, 2033A-01R, 2033A-3R, 2033A-04R, 2033A-05R, 2032A-02D, 2032A-02D, 2049A-02D, 2049A-01R, 2070A-01D, në Komunën e Prizrenit.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara për mungesë të votave, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime të votave, për faktin se thëniet e saj nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë vetëm te theksuara ne apel, gjë që për panelin pritet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit dhe mungesë të votave, andaj pala ankuese nuk i ka argumentuar shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Valon Kurtaj, nga subjekti politik LVV, nuk është i bazuar me asnjë dëshmi ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

**Anr.946/2021 më datë 07.11.2021**



**Kryesues i Panelit  
Burim Ademi**

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.